



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 01.03.2025

Nr: 217

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN**  
**NR. 52 ID, DATË 24.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË**  
**KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT**

Sot më datë 01.03.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**SUBJEKT:** **Zj. Emiriana Sako**  
Kryetare e Bashkisë Durrës

**OBJEKT:** Konstatimi i kryerjes së veprimtarive publike të ndaluara në Bashkinë Durrës

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

**KONSTATOJ:**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit më datë 24.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 52ID.

Në këtë denoncim Komiteti Shqiptar i Helsinkit parashtron sa vijon:

*“Në Bashkinë Durrës më datë 03.02.2025 në faqen zyrtare të saj, është shpallur një njoftim, nëpërmjet të cilit janë hapur aplikime për projekte për promovimin e artit, kulturës, sportit dhe një qendër kulturore, turistike dhe sportive. Projektet përfshijnë aktivitete si koncerte, panairë, ekspozita aktivitete sportive etj..”*

Data: 01.03.2025

Nr: 217  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 52 ID datë 24.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit”

*Për sa më sipër, një iniciativë e tillë e marrë nga ana e Bashkisë Durrës 4 muaj para datës së zgjedhjeve krijon indicie se një veprim i tillë i bie ndesh me Kodin Zgjedhor dhe Vendimin nr.9/2020 të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.”*

Nga sa më sipër çmohet se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:  
- Zj. Emiriana Sako, Kryetare e Bashkisë Durrës.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**